



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 111

Prishtinë, më 23.5.2024, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rrustemi, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni Kaloshi, Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Antigone Isufi, Kallxo.com, Viona Bunjaku, Lëvizja Fol, Ridvan Slivova, Telegrafi, Flutura Sogojeva, Ekonomia Online;

Stafi mbështetës i Komisionit: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi Projektligjit nr. 08/1-307 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për Shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me Qëllim të Ekzekutimit të Dënimeve Daneze;
3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L- 256 për falimentimin;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-277 për sport;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-264 për rininë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshime me propozimin e deputetit Dimal Basha, që të përfshihet si pikë e dytë e rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe me propozimin e kryetarit, që pika 5 dhe 6, dy raportet me amendamente të renditen si pika të para.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149;

Dimal Basha, tha se grupi punues ka përfunduar ndryshim-plotësimin e Ligjit për noterinë dhe kemi marrë parasysh të gjitha vërejtjet. Ka qenë një punë e mirë dhe mund ta procedojmë projektligjin për në seance.

Hajdar Beqa, kërkoi nga deputeti Dimal Basha, që të sqarojë më tutje se çfarë kanë ndryshuar në projektligj sepse raporti ka ardhur me vonesë.

Dimal Basha, theksoi se nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh, mirëpo, njëra prej ndryshimeve kryesore është problemi që e kemi me noterët që e kalojnë testin dhe trajnohen dhe të tjerët mbesin jashtë dhe ndryshimi që ka ardhur me projektligjin e ri, është që ka noterë rezervë, pra ata që nuk e plotësojnë numrin, trajnohen dhe mbesin në një listë rezervë. Do të jetë një regjistër që e mban edhe Ministria dhe Oda e Noterëve, ku në rast që një noter pensionohet, që të mos presim të hapim konkurs dhe të bëjmë trajnim gjashtëmuor, ku merr kohë afër një vit për të zëvendësuar e kemi një regjistër me kandidatë rezervë, ku me automatizëm hyn në funksion dhe ky është ndryshimi më substancial, ndërsa të tjerat janë ndryshime kozmetike. Ndërsa, për afatet dhe të gjitha detajet tjera, ka mbetur për tu rregulluar me akt nënligjor .

Hajdar Beqa, tha se është një ndryshim që nuk ka qenë në ligjin bazë, mirëpo, tek çështja e listës rezervë, atëherë obligohet Oda e Noterëve dhe Ministria, që ta respektojë renditjen që të mos ndodhë ndonjë keqpërdorim dhe të shkohet sipas dëshirave.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni me 5 vota për dhe dy abstenime, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

- 1. Miratohet raporti me amendamente për Projektligjin nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149;**

2. Projektligji nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore;
3. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-277 për sport;

Kryetari theksoi, se Komisioni, për Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, ka paraqitur 47 amendamente ne Projektligjin nr. 08/L-277 për sport. Komisioni për Legjislacion në pajtim me 76 paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se, me gjashtë vota për dhe një abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 08/L-277 për sport dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-264 për rininë;

Kryetari theksoi, se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport ka paraqitur 13 amendamente në Projektligjin nr. 08/L-264 për rininë . Komisioni për Legjislacion, në pajtim me 76 paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se, me shumicë votash, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.08/L-264 për rininë dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L- 256 për falimentimin;

Kryetari, komisionet kryesore e kanë trajtuar raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-256 për falimentimin sipas fushëveprimtarisë së tyre dhe ky është projektligj i Komisionit për Legjislacion të cilin e kemi kaluar në mbledhjen e kaluar, por që tani, pas shqyrtimit të komisioneve të përhershme, ta miratojmë përfundimisht, por paraprakisht gabimet teknike në amendamentet nga 9 deri 14 te raportit te rregullohen teknikisht si dhe në amendamentin 28 referenca në nenin 81 është gabim, e njëjta duhet të jetë në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. pra amendamenti duhet të ndryshohet si vijon tha deputeti Rrustemi.

Neni 82, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, togfjalëshi “mund të përmisohet”, ndryshohet me togfjalëshin “mund të përmirësohet

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t’i rekomandohet për lexim të dytë, Projektligji nr. 08/L- 256 për falimentimin

6. Shqyrtimi Projektligjit nr. 08/l-307 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për Shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me Qëllim të Ekzekutimit të Dënimeve Daneze;

Kryetari, potencoi se bëhet fjalë për marrëveshjen në mes Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës, e cila fatkeqësisht dështoi të votohet në seancën e kaluar në Kuvendin e Kosovës. Kjo është një marrëveshje e diskutuar gjatë dhe një pjese e madhe e këtij komisioni e kemi vizituar Mbretërinë Daneze, ku jemi njohur nga afër edhe me përmbajtjen edhe me vlerësimin, por edhe me kushtet e institucioneve në Mbretërinë e Danimarkës. Në aspektin e përgjithshëm, ky traktat forcon raportet mes Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës, si një aleat i rëndësishëm për Kosovën që i ka qëndruar pranë në momentet më të rëndësishme e që vazhdon ta mbështes në afirmimin ndërkombëtar të sovranitetit të shtetit tonë. Më pas, ai shtoi se për sa kohë nuk ka vërejtje esenciale përmbajtjesore shpreson që ky traktat të kalojë në Kuvendin e Kosovës.

Meqë nuk pati diskutime te tjera, kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota për dhe dy abstenime, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, Projektligji nr. 08/l-307 për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për Shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me Qëllim të Ekzekutimit të Dënimeve Daneze..

7. Te ndryshme;

Kryetari, tha se kemi pranuar një shkresë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, në lidhje me anëtarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, z. Visar Krasniqi. Në këtë shkresë ka pretendime se bien ndesh i zgjedhuri Visar Krasniqi me Ligjin për KPK-në, natyrisht pretendimet janë të pabazuara.

Rrustemi propozoi që si komision t’i kthehet përgjigje Këshillit Prokurorial të Kosovës, që procesi i zgjedhjes ka qenë krejtësisht në rregull në përputhje me ligjin për KPK-në dhe se z. Krasniqi i ka përmbushur të gjitha kriteret. Komisioni për Legjislacion e ka shpallur konkursin, janë dërguar

ftesat, është nominuar nga organizatat e shoqërisë civile, është themeluar grupi i punës, janë trajtuar propozimet dhe grupi i punës ka ardhur me një raport me të cilin është eliminuar njëri nga kandidatët në fazën fillestare, për të vazhduar pastaj me dy të tjerët në intervistën me gojë. Komisioni ka paraqitur rekomandimin në seancë dhe seanca me votim të fshehtë, ashtu siç parashihet, ka votuar, sqaroi deputeti Rrustemi.

Më pas njoftoi anëtarët edhe me përgjigjen nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ku për të njëjtën çështje është kërkuar opinion në lidhje me atë, se a përbën konflikt interesi pozita e zyrtarit në administratën e Kuvendit, por përgjigja e agjencisë ka qenë se nuk përbën rasti konflikt interesi.

Hajdar Beqa, z. Krasniqi ka qenë staf civil dhe ka marrë mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile në harmonizim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pajtohem që të kthejmë një letër ku potencohet se z. Krasniqi është zgjedhur në harmonizim me të gjitha procedurat që burojnë nga Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Besnik Tahiri, si Komisioni i kemi përcjellë të gjitha procedurat administrative të cilat Kuvendi i Kosovës i ka përcaktuar dhe i ka filtruar mbi bazën e kritereve. Në komision kanë ardhur referenca të drejtpërdrejta prej akterëve të shoqërisë civile dhe organizatave të ndryshme të cilat kanë kredenciale, dhe janë institucione shumë të respektuara, të cilat e monitorojnë Kuvendin dhe kërkojnë që kjo letër të trajtohet me shumë seriozitet, duke u pajtuar që komisioni të kthejë një përgjigje ku mbështetet tek parimi i procedurës dhe tek parimi i kritereve.

Meqë nuk kishte diskutime tjera anëtarët e komisionit u dakorduan njëzëri që të kthehet një përgjigje në lidhje me shkresën e dërguar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, me përmbajtjen si vijon:

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur më 23.5.2024, është njoftuar me shkresën tuaj me nr.756/2024 të datës 8.5.2024, ku njoftohet Kryetari i Kuvendit, në lidhje me zgjedhjen e anëtarit joprokuror nga Kuvendi.

Në lidhje me këtë, Komisioni për Legjislacion, si Komision funksional, ju njofton se zgjedhja e z. Visar Krasniqi, anëtar joprokuror, përfaqësues i shoqërisë civile, ishte në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit nr.06/L-056, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, për faktin se i njëjti në përputhje me kriteret ligjore, ju ka nënshtruar konkursit të shpallur nga Kuvendi. Po ashtu, pas zhvillimit të procedurave, Komisioni për Legjislacion në raportin e datës 2 shkurt 2024, kishte poentuar si kandidatin me më së shumti pikë. Mbi bazën e këtij procesi, i cili është monitoruar edhe nga organizatat kredibile të shoqërisë civile, Kuvendi me 7 mars 2024, pas procesit të fshehtë të votimit, me 74 vota, e zgjodhi anëtar të Këshillit.

Andaj, konstatimi se i njëjti nuk është pjesë e shoqërisë civile, është i paqëndrueshëm, për faktin se Ligji e kërkon të jetë i nominuar, e jo anëtar i shoqërisë civile, e që në rrethana të rastit konkret, z. Krasniqi ka qenë i rekomanduar, përkatësisht i nominuar nga pesë organizata të shoqërisë civile, me çka komisioni ka verifikuar dosjen e secilit kandidat dhe kriterin e kërkuar me nenin 3, paragrafi 3.3, të Ligjit nr. 06/L-056, për Këshillin Prokurorial të Kosovës .

Për më tepër, shkresa e juaj, shkëputur përmend disa dispozita të Ligjit nr.06/L-056, si ajo në nenin 8 paragrafi 2, dhe nenin 75 të Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publikë, që nuk kanë relevancë për rastin konkret.

Sa i përket papajtueshmërisë së përcaktuar me nenin 8 të Ligjit, ju rikujtojmë se fryma e këtij neni përcakton, se anëtari **nuk mund të ushtrojë në të njëjtën kohë dy funksione**. Kjo logjikë është ndjekur edhe tek Ligji nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ku në nenin 9 paragrafi 2, përcaktohet se “ 2. Anëtari i zgjedhur i Këshillit shkarkohet nga Këshilli, nëse ky nuk jep dorëheqje nga një pozite që është në mospërputhje para emërimit si anëtar i Këshillit, **apo nuk e pezullon pozitën sipas nënparagrafit 1.6 të këtij neni** ” Për më tepër se kaq, neni 8 paragrafi 2 i Ligjit nr.06/L-056, kur flet për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit, këtë duhet kuptuar se i referohet anëtarëve prokurorë, sepse nuk është në mandat të Këshillit, shkarkimi i anëtarëve joprokurorë, për faktin se këtë kompetencë e ka Kuvendi i Republikës së Kosovës, të përcaktuar me nenin 10, paragrafi 10, të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kjo çështje ka mundur të ngritët si dilemë eventuale e juaja para dhënies së betimit, por me të drejtë është supozuar se me pezullimin e pozitës, është konsumuar ky obligim dhe i hap rrugë dhënies së betimit. Kjo vërtetohet me vendimin DMBNJ-3.01.PDE/24 për pezullimin e marrëdhënies së punës.

Andaj, duke ju falënderuar për bashkëpunimin, vlerësojmë se zgjedhja dhe mandati i anëtarit z. Visar Krasniqi, është në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Kryetari, sqaroi se ka një lëshim teknik tek raporti me amendamente për Projektligjin për Falimentim, ku në amendamentin 28, referenca në nenin 81 është gabim, e njëjta duhet të jetë në nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, pra amendamenti duhet të ndryshohet si vijon:

Neni 82, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, togfjalëshi “mund të përmisohet”, ndryshohet me togfjalëshin “mund të përmirësohet”.

Mbledhja përfundoi ne orën 9:20

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
